



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 313 Prot.

Tiranë, më 01.03.2018

**VENDIM Nr. 33, datë 21.02.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, datë 21.02.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *Shtesës së projektit "Kompleks turistik "IONIAN OLEA", me vila 2 dhe 3 kat", në Drimadhë, Bashkia Himarë*-subjektet Znj. Mirela Papuli, Z. Artan Dumi, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *Shtesës së projektit "Kompleks turistik "IONIAN OLEA", me vila 2 dhe 3 kat", në Drimadhë, Bashkia Himarë*-subjektet Znj. Mirela Papuli, Z. Artan Dumi, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.
2. Punimet e gërmimit të Shtesës së projektit "Kompleks turistik "IONIAN OLEA", me vila 2 dhe 3 kat", në Drimadhë, Bashkia Himarë do të kryhen sipas akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur më parë për këtë zonë.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**